



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 427, datë 8.7.2021

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.26, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT
PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT
TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË
DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 2, e vendimit nr.26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ 2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në bashkitë Kamzë dhe Kavajë, në masën 914 561 348 (nëntëqind e katërmëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit dhe detajohet, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 445 562 231 (katërqind e dyzet e pesë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

- b) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi në masën 468 999 117 (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Efekti financiar, sipas kësaj pike, të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë e Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ